

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, Zj. Juliana Hoxha, me shkresën nr.8275 Prot, datë 29.12.2016, drejtuar juve Z. Pilo, ka kërkuar trajtimin e rastit sipas ligjit, por deri më sot, detyrimi i dhënies së informacionit të kërkuar prej Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, nuk është kryer.

Pra, në qëndrimin e derisotëm të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, nuk është respektuar dhe nuk respektohet detyrimi ligjor në marrëdhënien me Institucionin e Avokatit të Popullit, sikurse sanksionuar në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se : *“Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij“*, si dhe parashikimin e kryer në nenin 19, pika b , të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 *“ Për Avokatin e Popullit “*, të ndryshuar, se : *“ Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*. Referuar ligjit nr.8730 , datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, neni 21, përmbarruesi gjyqësor është i detyruar të njohi, respektoj dhe zbatoj Kushtetutën, K.Pr.C., K.C. dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbarrimore, si dhe urdhërat, udhëzimit dhe metodikat e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Në shkresat drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, është përcaktuar afati sa më i shpejtë por jo më shumë se 10 ditë. Edhe pse është konsumuar afati për dhënien e informacionit të kërkuar, Zyra e Përmbarrimit, Lushnje, nuk ka prezantuar ndonjë justifikim rreth shkaqeve të mospërmbushjes së kërkesës nr.K3/Gj43-3 Prot, datë 01.07.2016, të Avokatit të Popullit.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se, Kryetari i Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, apo përmbarruesi gjyqësor i çështjes, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë penges për ushtrimin e detyrës nga ana e Institucionit tonë në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm

Mosrespektimi i detyrimit ligjor nga ana e subjektit përfaqësues të organit të lartpërmendur, për kthimin e përgjigjeve rreth kërkesave të dërguara, vjen ndesh me parimin e ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe i efçencës, sikurse parashikuar në nenin 4, 5, 6, 10, 13, 15 dhe 18, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*, dhe të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Kjo situatë e krijuar prej qëndrimit që mbahet prej Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, apo përmbarruesit gjyqësor të çështjes, gjithashtu nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 *“Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje, apo përmbarruesit gjyqësor të çështjes, si rrjedhojë e mosdhënies së informacionit të kërkuar në procesin e shqyrtimit të çështjes së prezantuar prej shtetasit Gj.P.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

Kopje të shkresës nr. K3Gj438-4 Prot, datë 01.07.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje.

Kopje të shkresës nr. K3Gj438-7 Prot, datë 10.10.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje.

Kopje të shkresës nr. K3Gj438-8 Prot, datë 09.12.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit, Lushnje.

Kopje të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.612, datë 08.09.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lushnje.

Kopje të shkresës nr. 8275/1 Prot, datë 29.12.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**